




REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA  
KOMUNA E VITISË - OPŠTINA VITINA

Pranuar - Primijeno Me/Dana			
17.07.2012			
Nr.l organit Org.broj	Numri/Broj	Shtojcë Prilog	Vlera Vrednost
01-013/860			



REPUBLIKA E KOSOVËS

KOMUNA E VITISË

DREJTORIA PËR SHËNDETËSI DHE PUNË SOCIALE

RREGULLORE

PËR

NDARJËN E NDIHMAVE MOMENTALE NË TË HOLLA

Viti 2012

Në pajtim me nenin 12 pika c, të Ligjit nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, neni 43, paragrafi 3 rregulla financiare dhe udhëzimet e Thesarit 02, shpenzimi i parave publike, udhëzimit Administrativ nr. 2005/08, MEF-it , klasifikimi ekonomik i shpenzimeve dhe neni 36, shkronja c të Statutit të Komunës së Vitisë, nr. 01-013/491 të datës 21.04.2011, Kuvendi i Komunës së Vitisë më datën 13.07.2012 miratoi këtë:

## **R R E G U L L O R E**

### **P Ë R**

### **NDARJËN E NDIHMAVE MOMENTALE NË TË HOLLA**

#### **I. DISPOZITAT E PËRGJTHSHME**

##### **Qëllimi** **Neni 1**

1. Me këtë rregullore përcaktohen kriteret dhe procedurat e ndarjes së mjeteve të buxhetit të komunës, fondi për transfero, për ndihmë momentale personave fizik dhe juridik.
2. Bazuar në fondin e ndarë buxhetor të transfereve për vitin aktual, Kryetari i Komunës, sipas kërkesave të arsyetuara të palëve, ndan mjete financiare buxhetore (ndihme momentale) për personat juridik dhe fizikë, sipas procedurës së përcaktuar me këtë rregullore.

##### **Neni 2**

Ndihma momentale sipas kësaj rregullore konsiderohet ndihmë e menjëhershme, në para të gatshme, që propozohet nga komisioni përkatës i formuar me vendim të Kryetarit të Komunës.

#### **1. Ndihmat për individë dhe familje**

##### **Neni 3**

Në raste urgjente të fatkeqësive të ndryshme natyrore, varfëri të skajshme, për familje apo individ të caktuar për banoret e Komunës së Vitisë, sëmundjes së rëndë që kërkojnë mjekim të kushtueshëm, Kryetari i Komunës në bashkëpunim me drejtorin e Drejtorisë për Shëndetësi dhe Punë Sociale, sipas kërkesave të arsyetuara, ndan ndihmë momentale nga fondi për transfere të Komunës.

##### **Neni 4**

1. Kryetari i Komunës lejon ndarjen e ndihmave nga fondi për transfere dhe subvencione të Zyrës së Kryetarit në raste të fatkeqësive natyrore, varfërive të skajshme për familjet apo individët të

caktuar, sëmundje të rënda që kërkon mjekim të kushtueshëm , sigurimin e çështjes së strehimit (banimit) e cila ndihmë mund të jetë maksimumi deri në 5000 (pesëmijë€).

2. Kryetari i Komunës së Vitisë ndanë ndihma financiare për familjet e dëshmorëve të cilët nuk janë përfshirë në skemën e kompensimit material sipas Ligjit.
3. Drejtori i Drejtorisë për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale ndanë ndihma materiale për familje apo individ në nevojë dhe Organizata joqeveritare e cila ndihmë mund të jetë maksimumi deri në 300Euro.
4. Ndërsa komisioni i formuar me vendim të Kryetarit të Komunës propozon ndarjen e transfereve për individët, familjet me ndihmë materiale dhe përkujdesje shëndetësore e sociale si dhe subvencione për OJQ-të në shumë prej 100 deri 300 Euro.
5. Ndihma materiale e cekur ne paragrafin 1 dhe 2 të këtij neni nënkupton sigurimin e të hollave, ushqimit apo kompensimin e trajtimit të domosdoshëm mjekësor për një individ apo familje.
6. Për çdo shumë më të lartë nga ajo e përcaktuar në paragrafin 1 dhe 2 të këtij neni vendos Kuvendi i Komunës.

#### **Neni 5**

Ndihmat momentale (mjetet nga fondi për transfere ) janë pagesa të njëanshme jo të kthyeshme, për individë dhe familje.

#### **Neni 6**

1. Kriteret që duhet të plotësohen për të qenë përfitues i ndihmës momentale:
  - 1.1. Sëmundja e rëndë e konstatuar me dokumentacionin mjekësorë të specialistit;
  - 1.2. Gjendja e rëndë ekonomike familjare e vërtetuar;
  - 1.3. Dëshmia e shpenzimeve mjekësore dhe shpenzimeve të tjera; dhe
  - 1.4. Dëshmia për dëmet e shkaktuara nga fatkeqësitë elementare.

#### **Neni 7**

Kërkesë për ndihme momentale mund të paraqesin vetëm personat dhe familjet qe janë banorë të përhershëm të Komunës së Vitisë.

### **2. Ndihmat momentale - subvencionet për OJQ-të lokale**

#### **Neni 8**

1.Kriteret për shqyrtimin dhe vlerësimin e kërkesave të OJQ-ve bazohen në:

- 1.1 Promovimin e vullnetarizmit;
- 1.2 Integrimin e grupeve të marginalizuara;
- 1.3 Organizimin seminareve, trajnime, kurse për aftësimin e personave me aftësi të kufizuara.

3. Kërkesa duhet të këtë provat si në vijim:

- 2.1 Projekt-propozimi (në projekt propozim duhet të përshkruhet aktiviteti me agjendën e planifikuar si dhe specifikimi);
- 2.2 Certifikata e OJQ-së ;
- 2.3 Fotokopja e kartelës së xhirrologarisë dhe letërnjoftimin e bartësit të kartelës;
- 2.4 Shënimet e personit kontaktues.

### **Organi kompetent për shqyrtimin e kërkesave**

#### **Neni 9**

1. Kompetent për shqyrtimin e kërkesave për ndihma momentale për individ, familje, dhe subvencione për OJQ-ë, për ndihmën momentale, është Komisioni i formuar nga Kryetari i Komunës në përbërje të të cilit është drejtori i Drejtorisë për Shëndetësi dhe Punë Sociale si dhe zyrtar të Drejtorisë për Shëndetësi dhe Punë Sociale. Ky Komision ka për detyrë që të shqyrtojë kërkesat dhe të propozon ndihme momentale.
2. Kërkesat e pakompletuara, Komisioni nuk do të procedoj me tutje.
3. Kërkesat që nuk i plotësojnë kriteret për ndihmën momentale do të refuzohen nga komisioni i formuar nga Kryetari i Komunës.

#### **Neni 10**

Shuma e ndihmës momentale për individ, familje dhe OJQ, propozohet nga Komisioni dhe mund të ndihmohet vetëm një herë në vit me përjashtim të rasteve të jashtëzakonshme.

#### **Neni 11**

Komisioni për çdo kërkesë përpilon procesverbal me të cilën e aprovon apo e refuzon kërkesën për ndihmë momentale.

#### **Neni 12**

Kërkesa duhet të shqyrtohet jo më larg se 30 ditë nga dita e paraqitjes së kërkesës.

## **II. DISPOZITAT KALIMTARE DHE PËRFUNDIMTARE**

#### **Neni 13**

Për zbatimin e kësaj rregullore do të kujdeset Kryetari i Komunës, Drejtorja për Shëndetësi dhe Punë Sociale si dhe Drejtorja për Buxhet dhe Financa e Komunës së Vitis

#### Neni 14

Në raste konflikti të dispozitave të kësaj rregulloreje dhe dispozitave të rregullave financiare dhe Udhëzimit të Thesarit 02, shpenzimi parave publike dhe Udhëzimi Administrativ nr. 2005/08 MEF-it, klasifikimi ekonomik i shpenzimeve, do të aplikohen dispozitat e këtyre te fundit.


#### Hyrja ne fuqi

#### Neni 15

Kjo rregullore hynë fuqi pas miratimit nga Kuvendi dhe nënshkrimit nga Kryesuesi i Kuvendit të Komunës së Vitisë.

Viti, më 13.07.2012

Kryesuesi i Kuvendit Komunal

  
/ Skenderbe Hebib /

